

BULETINI I IGJK Gusht – Shtator 2004

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës për aktivitetet e IGJK. Ky publikim i është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK tani përmbanë artikuj nga stafi i IGJK në lidhje me qështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

EKSPROPRIIMI DHE KOMPENSIMI *

1. Hyrje

Një nga mënyrat e fitimit ligjor të së drejtës së pronësisë në mënyrë orgjinere mbi sendin e paluajtshëm për të cilin ekziston e drejta e pronësisë private është ekspropriimi. "Ekspropriimi apo shpronësimi është kalim i pronës private në atë shtetërore, për interes të përgjithshëm dhe me kompensim"¹.

Duke pasur për bazë Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, të datës 10.06.1999, në Kosovë fillon një faqe e re e zhvillimit të legjislacionit, në përgjithësi, përfshirë edhe atë të lëmisë juridiko civile.

Nëse i qasemi konkretisht ekspropriimit nuk gjejm ndonjë Rregullore të UNMIK-

* Ky punim paraqet një përpunim të ideve të prezentuara në trajnimin për gjyqtarët e lëmisë civile të mbajtur në Institutin Gjyqësor të Kosovës më 07.07.04, ku autori është trajnues gjyqësor.

¹ Abdulla Aliu "E drejta sendore" (PRONËSIA), Prishtinë 2004, fq.124

ut me anë të së cilës është rregulluar kjo fushë, por kjo nuk do të thotë se kjo fushë është e pambuluar në aspektin ligjor. Me Rregullorën nr.1999/24 të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (PSSPKB), ligje në fuqi do të jenë:

"[...]

- a. Rregulloret e shpallura nga PSSP dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, dhe
- b. Legjislacioni që ishte në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989.

Në rast konfliktesh do të mbizotrojnë rregullorët dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to, të cilat do të kenë përparsi.

Nëse gjykata e juridiksionit kompetent, nga organi ose nga personi është kërkuar implementimi i dispozitës ligjore, ndërkaq kur ai përcakton se objekti i lëndës apo situata nuk është e mbuluar me ligjet e parapara në pjesën 1 të Rregullorës në fjalë, por është mbuluar me ligjin tjetër në fuqi në

Kosovë pas 22 marsit 1989, i cili nuk është diskriminues dhe i cili është në pajtim me pjesën 3 të Rregullorës, atëherë gjykata, organi a personi, si përjashtim, do të aplikoj atë ligj”. Konkretisht kur është në pyetje ekspropriimi ai është i rregulluar me Ligjin mbi ekspropriim të viteve 1978 dhe 1986.

Prandaj, në bazë të ligjit në fuqi “Objekt ekspropriimi është pasuria e patundshme kur kjo është e nevojshme me qëllim të ndërtimit të objekteve ekonomike, banimi, komunale, shëndetësore kulturore dhe objekteve tjera me interes të përgjithshëm”².

Ekspropriimi i pasurive të patundshme përfshirë ndërtimin e hekurudhave, rrugëve, urave aeroportive etj. nga sa u tha më lartë bëhet me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm shoqëror. Por, shtrohet çështja se cili është interesi i përgjithshëm shoqëror dhe kush e cakton këtë interes të përgjithshëm shoqëror? Përgjigjen rreth kësaj mund ta gjejm pikërisht në Ligjin mbi ekspropriimin përkatësisht në nenin 3 të tij ku decidivisht theksohet:”

Interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objekteve të caktuara respektivisht zhvillim e punëve në pasurinë e patundshme për të cilën ekziston plani i hollësishem urbanistik caktohet me atë plan”. Pra, nga kjo buron se plani urbanistik është ai me të cilin determinohet interesi i përgjithshëm

² Neni 2 i Ligjit mbi ekspropriimin GZ e KSAK-së nr.21/78

shoqëror. Por, nga kjo ka një përjashtim sepse edhe në rastet kur nuk ekziston plani urbanistik, Asambleja komunale gjegjesisht Ekzekutivi i Komunës me vendim të vecantë mund të ndërmarrë hapat drejtë ekspropriimit të pasurisë së patundshme.

Aktualisht duke pasur parasysh kompetencat e kufizuara të Asambleve komunale në Kosovë në drejtim të administrimit të pronësisë së tyre³, si dhe kur kësaj i shtohen edhe mospajtimet rreth vijave ndarëse (kufinjëve) në mes të Komunave këtë çështje e bënë edhe më të ndieshme, reperkusionet e të cilave reflekton me rastin e vendosjeve të çështjeve praktike nga ana e gjykatave përkitazi me ekspropriimin.⁴

Këto dhe çështjet tjera përkitazi me ekspropriimin do të përqipemi t'i shqyrtojm në vazhdim nepërmjet pikave vijuese.

2. Procedura për caktimin e shpërblimit për pasurinë e ekspropriuar

Në aspektin e përgjithshëm është e drejtë e cdo qytetari që të posedoj pronësin e tij dhe ti vjel frytet që dalin nga ajo e drejtë e pronësisë cofshin ato civile apo në natyrë.

³ Në këtë rast mendohet në ingerencat e AKM-së

⁴ P.sh.Rasti i pazgjidhur në mes të Asambles Komunale të Prishtinës dhe Fushë Kosovës lidhur me vijën ndarëse në mes tyre;

Mirëpo, edhe pse kështu theksohet parimisht, në jetën e përditëshme mund të ndodhin përjashtime në dobi të realizimit të interesave të përgjithshme shoqërore ose thënë më konkretisht kur vjen në shprehje ekspropriimi si masë e kufizimit të realizimit të së drejtës së pronësisë.

Nga sa u theksua më lartë ekspropriimi bëhet në interes të përgjithshëm shoqëror, por jo në dëm të palës tjetër gjë që determinon të drejtën në një shpërblim në dobi të pronarit të mëhershëm.

Ekspropriimi mund të jetë i plotë dhe jo i plotë. Ekspropriimi i plotë ekziston kur patundshmëria kalon në pronësi shoqërore. Me ekspropriim jo të plotë themelohet servituti mbi sendin e paluajtshëm apo qiramarrja e tokës punuese për kohë të caktuar.⁵

Nga sa u tha më lartë për patundshmërin e ekspropriuar pronarit i takon shpërblimi i drejtë të cilin e paguan shfrytëzuesi i ekspropriimit. Me shpërblimin e caktuar duhet mundësuar ish pronarit që të zëvendësoj sendin e paluajtshëm të ekspropriuar në një send tjetër, ose ndryshe ta riparoj sendin e till. Kompenzimi për pasurinë e ekspropriuar zakonisht caktohet në para, por me marrëveshjen e palëve ai mund të caktohet në dhënie të patundshmërisë tjetër. Poqese kemi të bëjmë me eksproprium e ndërtesës

banesore, shfrytëzuesi i ekspropriimit ka detyrë që para prishjes së saj ta siguroj banesën tjetër adekuate për pronarin e mëparshëm apo bartësin e të drejtës banesore.

Kompensimi për tokën bujqësore caktohet sipas vlerës në treg të tokave bujqësore, e ai për objektet ndërtimore në bazë të vlerës ndërtimore të objektit të ekspropriuar.⁶

Lartësia e kompensimit për sendin e paluajtshëm të ekspropriuar caktohet duke i marrë parasysh rrethanat ekzistuese në momentin e nxjerrjes së vendimit të shkallës së parë mbi shpërblimin.⁷ Në rast qiramarrje, shpërblimi caktohet në lartësi që realizohet për tokën e afërtë të ngjashme.

Propozimi për ekspropriim e parashtron shfrytëzuesi i ekspropriimit te organi administrativ kompetent për punë pasurore-juridike, dhe vetëm pasi të jetë konstatuar interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objektit përkatës.

Vendimin mbi eksproprium e jep organi administrativ në territorin e të cilit ndodhet sendi i paluajtshëm. Procedura zhvillohet sipas rregullave të parapara me Ligjin mbi eksproprium dhe Ligjin mbi procedurën e përgjithshme administrative.⁸

⁵ Nenet 46 dhe 47 të Ligjit mbi eksproprium (LE)

⁶ Nenet 28 dhe 29 të LE

⁷ Neni 30 i LE

⁸ LPPA GZ e RSFJ-së nr.47/86

⁹ Neni 25 i LE

¹⁰ Neni 17 i LE

¹¹ Neni 21a.4 i LE

Pasi të bëhet i formës së prerë vendimi mbi eksproprium shfrytëzuesi i eksproprium e fiton të drejtën e posedimit mbi sendin e paluajtshe të ekspropriumuar.⁹

Aktvendimi i shkallës së parë mbi propozimin për eksproprium mund të goditet me ankesë pranë organit të shkallës së dytë.¹⁰

Aktvendimi mbi eksproprium që është bërë i formës së prerë mund të anulohet sipas kërkesës së ish pronarit poqese shfrytëzuesi brenda afatit 3 vjeçar nuk i ka kryer punët e rëndësishme në objektin e paraparë. Ky afat fillon të ecë nga dita kur aktvendimi është bërë i formës së prerë.¹¹ Pas skadimit të afatit 10 vjeçar nga dita e përmendur nuk mund të kërkohet anulimi i vendimit mbi eksproprium. ¹²

Shpërblimi për pasurin e ekspropriumuar mund të zhvillohet në procedurë jashtë kontestimore dhe në procedure kontestimore. Zakonisht preferohet arritja e një ujdje në mes të pronarit të pasurisë së ekspropriumuar nga njëra anë dhe shfrytëzuesit të ekspropriumit nga ana tjetër në drejtim të caktimit të shpërblimit për pasurinë e ekspropriumuar.

Në këtë drejtim roli primar i takon organit administrativ kompetent për punë juridiko-pasurore i cili edhe e ka dhënë vendimin për eksproprium. Organi në fjalë ka për detyrë që të caktoj

seancën ex officio ku palët do të njiheshin me të drejtat dhe detyrat e tyre në formë të ofertës. Ujdja eventuale në mes tyre e përfshir në procesverbal i cili ka edhe fuqin e titullit ekzekutiv (titulus ekzekutionis)¹³, i dërgohet avokatit public kompetent.

Nëse avokati konstaton se palët kanë arritur ujdje për shpërblimin në dëm të bashkësisë shoqërore, ai ka të drejtë që të paraqes padi në gjykatën kompetente me kërkesë që ajo të anulohet atë.

Padia mund të paraqitet në afatin prej 15 ditëve prej ditës së marrjes së procesverbalit për marrëveshjen e lidhur mbi shpërblimin, e më së voni në afatin prej 6 muajve prej ditës së lidhjes së marrëveshjes. Padia e paraqitur e ndalon pagesën e shpërblimit për pjesën e kontestuar nga avokati publik.

3. Anulimi i aktvendimit të plotëfuqishëm për eksproprium dhe deeksproprium

Anulimi i aktvendimit të plotëfuqishëm për eksproprium mund të bëhet me marrëveshjen e palëve si dhe me kërkesën e pronarit të mëparshëm.

Në bazë të nenit 21 par. 3 të Ligjit për eksproprium parashihet që shfrytëzuesi i ekspropriumit dhe pronari i mëparshëm mund të kërkojnë së bashku anulimin e aktvendimit të formës së prerë për eksproprium, përveç ekspropriumit të kompleksit të tokës.

¹² Neni 21 al.5 i LE

¹³ Neni 50 al.4 i LE

Efektet juridik të këtij veprimi të palëve është kthimi i gjendjes së mëparshme, pra me këtë veprim anulohen të gjitha efektet që i kishte prodhuar aktvendimi për eksproprijimin.

Veprimin e këtillë të palëve duhet shiquar në aspektin material, pra që kërkesat e tyre duhet të shprehin vullnetin e lirë të palëve dhe në këtë drejtim nuk është e thënë që ato kërkesa formalisht edhe të paraqiten me një kërkesë të përbashkët me shkrim. Organi kompetent kur pranon kërkesën apo kërkesatë e palëve ai është i detyruar të marrë vendim për anulimin e aktvendimit të formës së prer.

Në këto raste organi administrativ vetëm konstaton ekzistimin e kërkesës së përbashkët të palëve përkatësisht se ato shprehin vullnetin e tyre të lirë. Por, në praktikë ekzistojnë raste kur deri te anulimi i aktvendimit në fjalë vjen si pasojë e vdekjes së ndonjërit nga palët.

Nga sa u theksua më lartë rezulton se anulimi i aktvendimit për eksproprijimin mund të bëhet edhe me kërkesën e pronarit të mëparshëm. Në nenin 21 parag. 4 të Ligjit për eksproprijimin parashihet se aktvendimi i formës së prer për eksproprijimin mund të anulohet edhe me kërkesën e pronarit të mëparshëm nëse shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin prej 3- viteve prej kohës kur aktvendimi për eksproprijimin ka marrë formën e prer, nuk ka kryer sipas natyrës së objektit punimet e nevojshme në atë objekt.

Kërkesën për anulimin e aktvendimit ka të drejtë ta paraqes pronari i mëparshëm i palujtshmërisë së eksproprijuar. Kjo e drejtë mund të bartet tek pasardhësit do të thotë është e trashëgueshme.

Sa i përket afatit për paraqitjen e kërkesës në fjalë ai vlersohet duke u nisur nga momenti i plotfuqishmërisë së aktvendimit dhe kalimit të afatit prej 3- viteve gjatë të cilit shfrytëzuesi i punimeve duhet të kryen punimet e nevojshme në objektin për të realizuar qëllimin për të cilin është bërë eksproprijimi.

Në nenin 21 par.5 të Ligjit mbi eksproprijimin parashihet edhe afati prej 5- viteve nga dita kur vendimi për eksproprijimin ka marrë formën e prer, nuk mund të paraqitet kërkesa në fjalë.

Lidhur me kërkesën për anulimin e aktvendimit për eksproprijimin vendos organi i cili ka marrë vendimin në shkallë të parë për propozimin për eksproprijim.¹⁴

4. Privimi (shpronësimi) nga e drejta në pronë sipas konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut u përpilua nën kujdesin e Këshilit të Europës dhe hyri në fuqi në vitin 1953. Përveç katalogut të të drejtave dhe lirive civile dhe politike, gjithashtu Konventa krijon një sistem me anë të të cilit mund të implementohen detyrimet përkatëse

¹⁴ Neni 21a.8 i LE

të shteteve anëtare. Kjo përgjegjësi i besohet tërë institucioneve: Komisionit Evropian të Drejtave të Njeriut, Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut dhe Këshillit të Ministrave të Këshillit të Europës.

Lista e të drejtave dhe lirive të garantuara me Konventë është mjaftë e gjatë në mesin e të cilave hyn edhe mbrojtja e pronës ku theksohet: "Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare..."¹⁵

Pra, nga kjo rezulton se Konventa Europiane garanton të drejtën për respektimin e pasurisë, që zakonisht quhet e drejtë e pronës. Por, duke patur parasysh përjashtimet e mundshme edhe në këtë rast Shteti mund të kufizoj ushtrimin e të drejtës së pronës, për arsye të realizimit të interesit publik gjegjësisht sipas kushteve të parashikuara me ligj.

Një nga këto mënyra të kufizimit të së drejtës së pronës është padyshim që paraqet rasti i eksproprijimit.

Duke patur parasysh administrimin ndërkombëtar në Kosovë si dhe statusin e pazgjidhur të saj shtrohet çështja e aplikimit të Konventës ndaj veprimeve të autoriteteve të UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Shtetet kontraktuese të Konventës duhet t'i sigurojnë çdo personi brenda juridiksionit të tyre të drejtat dhe

liritë e përcaktuara me Konventë. Në rastin e Kosovës kjo do të thotë se një aplikacion mund të paraqitet vetëm kundër një shteti që është një palë kontraktuese e Konventës. Pra, përjashtohet fakti që një aplikacion mund të paraqitet kundër OKB-së, UNMIK-ut, Kosovës sepse si i tillë ai do të ishte në kundërshtim me nenet 35. 3 dhe 4 të Konventës. Por, nga ana tjetër sipas Rezolutës 1244 të KS të OKB-së Kosova është nën administrimin e drejtpërdrejt ndërkombëtar të shteteve anëtare të OKB-së mbi bazën e pjesmarrjes së tyre në UNMIK.

Një situatë në të cilën mund të parashikojm përgjegjësin e shtetit është ajo e fuqive të lejuara për KFOR-in. P.sh. nëse Italia do të ishte përgjegjëse nën sistemin e Konventës për veprimet e kryera në Kosovë nga KFOR-i Italian mbi atë pjesë të territorit për të cilën është përgjegjës KFOR-i Italian.

Në bazë të praktikës gjyqësore të Gjykatës Europiane kur një shtet ushtron kontroll mbi një territor jashtë territorit kombëtar, ky shtet mund të jetë përgjegjës për vepra të kryera nga autoritetet e tij në këtë territor.¹⁶ Konform me këtë konsiderojm se personat e dëmtuar nga këto veprime konsiderohen se janë brenda juridiksionit të atij shteti dhe së këndejmi shteti është i detyruar t'u sigurojë atyre të drejtat sipas Konventës.

¹⁶ Lidhur me këtë shih: Yves Winisdoerffer dhe Anna Austin "Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut", Studime juridike në Kosovë vol.2, 2002/1, Prishtinë fq.3-6.

¹⁵ Neni 1 i Protokolit Nr:1

Prandaj, konsiderojm se pala e dëmtuari përfshir edhe rastet e eksproprijimit mund të paraqes aplikacion në Gjykatën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut me seli në Strasburg me kusht që territori në fjalë të gjendet nën kontrollin efektiv të atij shteti si dhe të jen përdorur të gjitha mjetet juridike të brendshme në drejtim të realizimit të së drejtës së garantuar me akte ligjore.

5. Punët përgaditore rreth eksproprijimit

Zakonisht para se të fillohet me eksproprijim duhet të kryhen një varg punë përgatitore e cila gjë është e parashikuar edhe me nenin 7 të Ligjit mbi eksproprijimin.

Këto punë kanë të bëjnë me ekzaminimin e tokës, matjet dhe punët tjera të nevojshme të cilat përfshihen në Propozim.

Pra, punimet përgaditore nuk paraqesin ndonjë formë të eksproprijimit dhe as ndonjë faze në zbatimin e kësaj procedure ,ato shërbejnë vetëm për përcaktimin definitiv të shfrytëzuesit të ardhshëm të eksproprijimit të cilat i paraprijn përcaktimit të interesit të përgjithshëm.

Pikërisht për shkak të natyrës dhe qëllimit të till të punëve përgaditore, është e mundur që investitori të kërkojë lejen për kryerjen e punimeve përgaditore në disa ngastra në fqinjësi, respektivisht për disa vende në regjionin e njëjtë, ashtu që, në mbështetje të të dhënave të mbledhura dhe rezultateve

të hulumtimeve të ndërmarra, të mund të vendos për kahjet e orientimit të tij në drejtim të paraqitjes së propozimit ,p.sh. me rastin e shpuarjes së tokës të përcaktoj qëndrueshmerin e shtresave të poshtme të tokës, prezencen e ujërave nëntokësore etj.

Edhe pse punët përgaditore nuk janë shprehimisht të numëruara në Ligj, mendojm se të tilla nuk konsiderohen edhe :

- ndërmarrja e punëve përgaditore në hapjen e punishteve ,
- ndërtimi i ndonjë rruge apo ure deri në cak,
- ndërtimi i përkohshëm banesave për vendosjen e punëtorve ,
- ndërtimi i depove për material ndërtimor dhe të ngjajshme.

Me fjalë të tjera kurrfar punesh ndërtimore nuk mund të ndërmirren në formë të punimeve përgaditore. Në të kundërten, organi kompetent i cili e ka lejuar ndërmarrjen e punimeve përgaditore do të ndalojë punët që janë jashtë kufive të paraparë në lejen për ndërmarrjen e këtyre punimeve.

Zënia e përkohshme e tokës nuk paraqet asnjë formë të eksproprijimit, zënia e përkohshme e tokës i shërben ndërtimit i cili kryhet në tokën e eksproprijuar në fqinjësi dhe vetëm këtë e kanë të përbashkët me eksproprijim.

Punimet përgaditore, për këtë qëllim mund të lejohen edhe për tokën në pronësi shoqërore për të cilën mendohet të propozohet bartja

administrative, në kuptimin e dispozitave të neneve 74 deri 76 të Ligjit në fjalë.

Në propozimin me të cilin kërkohet leja për kryerjen e punimeve përgaditore duhet theksohet:

- qëllimi për të cilin mendohet të propozohet ekspropriimi,
- pasuria e patundshme në të cilën propozuesi mendon të kryej punimet përgaditore,

- pronari i asaj pasurie të patundshme,
- natyra,
- vëllimi,
- qëllimi i punimeve,
- kohëzgjatja e tyre.

Përkitazi me propozimin për lejimin e kryerjes së punimeve përgaditore vendos organi komunal i administratës kompetent për punët pronësore juridike në bazë të kërkesës së palës.

LITERATURA

Prof.Dr.Abdulla Alu: “E drejta sendore (PRONËSIA),Prishtinë 2004

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut 1948

Prof.Dr.Faik Brestovci “E drejta procedurale civile “Prishtinë 2002

Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut

Ligji mbi ekspropriimin GZ e KSAK-së nr.21/78

Ligji mbi ekspropriimin GZ e KSAK-së nr.46/86

Ligji mbi proceduren e përgjithshme administrative GZ e RSFJ-së nr.47/86

Rregullorja e UNMIK-ut nr.1999/24

Yves Winisdoerffer&Anna Austin”Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut:Aplikimi në Kosovë dhe mundësia për të paraqitur një kërkesë pranë Gjykatës së të Drejtave të Njeriut”,Studime juridike në Kosovë, vol.2, 2002/1, Prishtinë 2002.

**Rrustem Qehaja, trajnues
gjyqësor nga IGJK**

Programi i Aktiviteteve për muajin Shtator 2004

Seminar nga e Drejta Civile – Ekzekutimi i Aktëgjykimeve Civile

Me 7, Shtator, Instituti Gjyqësor i Kosovës IGJK-ja do të organizoj një sesion trajnimi në lidhje me Ekzekutimin e Aktëgjykimeve Civile. Në këtë program trajnimi kryesisht do të fokusohemi në problemet rreth ekzekutimit të aktëgjykimeve civile gjatë fazës së tranzicionit. Gjatë prezantimeve do të diskutohet rreth procedurave aktuale në Kosovë në lidhje me këtë çështje, mënyra të ndryshme të ekzekutimit dhe mjeteve ligjore, ankesa kundër vendimit të ekzekutuar. Në fund të këtij sesioni trajnues një tryez e rrumbullaket do të organizohet në bashkëpunim me përfaqësuesit nga Departamenti i Administratës Gjyqësore (DAG), UNMIK-u dhe Banka Raiffeisen. 35 gjyqtarë janë të ftuar të marrin pjesë. Tre Trajnues Gjyqësor dhe një gjyqtarë nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë/Priština do të përgadisnin prezantime për këtë sesion trajnues.

Seminar për Gjyqtarët e Gjykatave për Kundërvajtje

IGJK-ja do të organizoj një program edukimi të veçantë për gjyqtarët të cilët punojnë në Gjykatat për Kundërvajtje në Kosovë, i cili do të mbahet me datën 16 Shtator. Ky seminar do të jetë përsëritëse e seminarit të mbajtur me 19 Shkurt, dhe 13 Maj të këtij viti dhe i cili trajnim është kushtuar gjyqtarëve nga Gjykatat për Kundërvajtje.

Ky program trajnimi ka të bëjë me çështje procedurale ligjore për të cilat Gjykatat për Kundërvajtje janë kompetente, duke përfshir çështjen e trafikut, dhe mbajtjen e rendit dhe qetësis. Tre gjyqtarë do të kontribuojnë këtij seminarit të cilët janë nga Gjykata e lartë për Kundërvajtje e Kosovës.

Seminar mbi Pengimin e Pastrimit të Parave

IGJK-ja do të organizoj një seminar mbi Rregulloren e UNMIK-ut 2004/2 mbi Pengimin e Pastrimit të Parave dhe çështjet rreth veprave penale të datës 21 dhe 22 shtator gjatë hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore me date 1 shtator. Ky seminar do të organizohet në bashkëpunim me shtyllen e parë (Qendra për Informin Financiar), Departamenti i Drejtësisë SHBA dhe Kshilli Evropian (KE). Rendi i ditës për këtë seminar kryesisht do të jenë tema të cilat fokusohen në konceptin e Pengimit të Pastrimit të Parave, rishikimi i legjislacionit të aplikuar në Kosovë, shtyllat të cilat efektivisht luftojnë anti-pastrimin e parave, monitorimin, zbulimin, ndjekjen dhe raportimin, si dhe përgjegjësitë përkatëse të institucioneve në fjalë siç është Banka Qendrore, Doganat, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, dhe sistemi penalo juridik. Ekspertët të cilët do të kontribuojnë këtij seminarit janë nga SHBA-ja, Kosova dhe Kshilli Evropian të cilët ekspert do të prezantojnë procedurat aktuale dhe praktik të mirë rreth kësaj çështje.

Tryezë e Rrumbullaket rreth Vendimet Gjyqësore

Me 28 shtator IGJK-ja do të organizoj një tryez të rrumbullaket për të diskutuar rreth modeleve dhe formave të vendimeve gjyqësore, në përputhshmëri me Kodin e Ri të Procedurës Penale të Kosovës. Një gjyqtarë nga Gjykata e Qarkut dhe një ekspert nga lamia penale të të kontribojn këtij sesioni lidhje me modelet dhe format e reja të vendimeve gjyqësore.